



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR MATURËN SHTETËRORE**

(Provim me zgjedhje)

**LËNDA:
GJUHË TURKE**

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Viti shkollor: 2013 -2014

**TIRANË
JANAR, 2014**

1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM MBI PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBËTAR TË MATURËS SHETËRORE PËR LËNDËN E GJUHËS TURKE DHE MBI PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Ky program orientues mbështetet në standardet e arritjes së mësimit të gjuhës turke dhe bazuar në udhëzimin e datës 26/12/2013 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit ‘Për Zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore’ ku gjuha e huaj është përcaktuar provim (lëndë) me zgjedhje. Niveli i njohurive i përket nivelit **B2** sipas dokumentit evropian “Kudri i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën turke, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Hartimi i këtij programi orientues mbështetet në programet e tre viteve të Kolegjit Turk, tekstet me të cilat është zhvilluar gjuha turke në Kolegjin Turk si edhe përvojën e fituar nga provimet e maturës shtetërore të viteve pararendëse, duke pasur parasysh zhvillimin e aftësive gjuhësore që do të testohen dhe standardet e gjuhëve të huaja. Ky program duhet të nxisë inspirim dhe sfidë për të gjithë nxënësit dhe t’i përgatisë ata për të ardhmen. Programi Orientues i gjuhës turke si provim (lëndë) me zgjedhje, është ndërtuar duke vlerësuar nevojat e nxënësve, ndryshimet që ata kanë pësuar gjatë tre vjetëve të Kolegjit Turk.

Synimet e Programit

Ky program synon:

- Të ndihmojë nxënësin në përgatitjen e tij për provimin e maturës në gjuhën turke.
- Të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve.
- Vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) dhe dy konceptet bazë, që janë: **të lexuarit dhe të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.**

- Të japë orientime për specialistët e gjuhës turke që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore.
- Vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, aftësinë për të përdorur gjuhën që është e përshtatshme për turqishten standarde (në aspektin e saj morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional).
- Të matë aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme në situatën e komunikimit me shkrim duke shprehur aftësinë e organizimit të ideve, mbrojtjes së ideve të tyre me shembuj dhe argumente nga jeta e tyre.

Synimet e Programit

Me anë të këtij programi synohet:

- të ndihmohen nxënësit maturantë në përgatitjen e tyre për provimin e gjuhës turke si lëndë me zgjedhje.
- të ndihmohet mësuesi i lëndës për t'u dhënë nxënësve orientimet e duhura.
- të bëhet vlerësimi i njëkohshëm i dy përbërësve të aftësisë së komunikimit, të cilët përbëjnë dy konceptet bazë të kësaj aftësie: të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.
- të jepen orientime për hartuesit e testeve të provimit kombëtar të Maturës Shtetërore për gjuhën turke.
- të vlerësohen të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, në aspektin e tyre morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional.
- të aftësohen nxënësit maturantë për të përdorur njohuritë gjuhësore në mënyrë të pavarur, korrekte dhe në përputhje me situatat e larmishme të komunikimit.

Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit

Mësuesit dhe nxënësit, që do të përdorin këtë program duhet të ketë parasysh specifikën e provimit të gjuhës së huaj, ku nxënësi do të përballet me një tekst krejt të ri mbi të cilin do të punohet, por tematika, strukturat gramatikore, si dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që janë studiuar gjatë tre viteve të Kolegji Turk.

Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (spor ve e lence,yemek,sa lık ve korunma, çevre sorunları, seyahat zamanı, modern ya am vb.)

Përsa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore (edilgen ve etken fiiller, art kipi, duyulan geçmiş zaman, **zamanlar**, zarf ve sıfatların özellikleri kar ıla tırılması, ba laçlar, v.b.) duke dalë nga konteksti i mësimave ku këto probleme trajtohen. Mësuesi duhet t'i verë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë *cümle tercümesi, yazım kuralları*, etj.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto funksione gjuhësore:

- Farkli ilgi alanları hakkında konuşma.
- Yerler hakkında bilgi verme ve tavsiyede bulunma.
- Basit konulardaki öneriyi teklif ve yorum yapma.

Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme kompozimi jo letrar (me tema të thjeshta). Ata duhet të përgatiten që të ndërtojnë paragrafë të saktë nga ana strukturore dhe leksikore. Gjithashtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të dinë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij në një tekst koherent. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur të shkruajë një email ose letër formale ose jo formale; të zbatojë rregullat e shkrimit të një email-i, një letre formale dhe joformale.

2. Aftësitë dhe njohuritë që duhet të zotërojë nxënësi maturant për të qenë i përgatitur për Provimin e Maturës në gjuhën turke.

Nxënësi që do t'i ushtrohet provimit të Maturës me Zgjedhje në Gjuhën Turke duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për çka më poshtë vijon:

2.1 Të lexuarit dhe të Kuptuarit (Okuma-anlama)

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose jo letrare, dhe për të gjykuar mbi të.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësim të shprehur me gjuhë të thjeshtë mbi atë çka i kërkohet.

Në mënyrë të përmbledhur, kjo aftësi përfshin:

- Kuptimin e tekstit në tërësi;
- kuptimin përzgjedhës: gjetjen e informacioneve apo të dhënave specifike që kërkohen;
- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;
- kuptimin e thelluar të tekstit: zbulimin e të pashprehurës, asaj që nënkuptohet;
- marrjen dhe përzgjedhjen e informacionit të duhur brenda një teksti të caktuar;
- reflektimin mbi përmbajtjen e një teksti dhe vlerësimin se sa me vend janë disa elemente të informacionit;
- zhvillimin e aftësisë interpretuese, duke nxjerrë një përfundim logjik;
- gjetjen e një informacioni sinonim;
- reflektimin mbi përmbajtjen e një teksti, duke u bazuar mbi disa vlera dhe bindje për të dhënë një gjykim në lidhje me moralin e një historie;
- zgjidhjen e ushtrimeve leksikore dhe gramatikore rreth tekstit.

2.2 Të shprehurit me shkrim (Yazma)

Në provimin e maturës nxënësi që do të zgjedhë gjuhën turke si gjuhë të huaj të parë, duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë jo shumë të gjerë temash duke i lidhur elementët në mënyrë koherente, duhet të jetë në gjendje të bëjë përshkrime jo shumë të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të pangarkuar me detaje, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, një e-mail formal dhe

joformal duke respektuar formatet e mësuara gjatë viteve që nxënësi ka studiuar këtë gjuhë, etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej **120-150 fjalësh**, në të cilin duhet të zhvillojë një temë mbi një çështje me interes të përgjithshëm e duke marrë shkas nga pjesa e panjohur ose që nuk ka lidhje me të. Nxënësi do të vlerësohet për: përmbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore si dhe strukturën e koherencën.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- Një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse, të cilat janë trajtuar gjatë mësimave në tre vitet e Kolegjit Turk.
- Nxënësi të paraqesë një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe sintaksore (letër zyrtare apo personale, paragrafë të lidhur në mënyrë logjike).
- Të lidhë në mënyrë koherente informacione nga burime të ndryshme.
- Të shprehë pikëpamjet e tij në formë të argumentuar.
- Të organizojë mirë përmbajtjen e punës me shkrim, duke qenë gjithnjë në koherencë me temën e dhënë.
- Të vendosë dhe të ruajë një këndvështrim të vetin dhe origjinal për temën mbi të cilën do shkruajë.
- Të shkruajë paragrafë të plotë në të cilët të ketë detaje dhe informacione specifike për temën e dhënë.
- Të ruajë rendin e mendimeve në të gjithë pjesën e shkruar.
- Të përdorë tipe dhe gjatësi të ndryshme fjalish.
- Të përdorë saktësisht të gjitha kohët dhe mënyrat, duke i përshtatur sipas specifikave të gjuhës turke.
- Të tregojë për organizimin e një feste, të flasë për karakterin dhe interesat e një personi.
- Të njohë dhe të përdorë saktë fjalët me shumë kuptime, sinonimet dhe antonimet.
- Të përdorë saktë parafjalët e thjeshta dhe të përbëra, duke bërë krahasimin dhe duke njohur ndryshimin nga ato të gjuhës shqipe.
- Të përkthejë saktë nga shqipja në turqisht dhe anasjelltas.
- Të formulojë urdhra, duke përdorur mënyrën urdhërore të drejtpërdrejtë ose indirekte.
- Të përdorë një leksik të pasur dhe të shkruajë saktë nga ana drejtshkrimore.

2.3 Türkçenin kullanımı (Përdorimi i Gjuhës)

Në këtë program njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës gjatë tre viteve të Kolegji Turkit, janë të dhëna përmes ushtrimeve, temave, bashkëbisedimeve që trajtojnë njësi të ndryshme gramatikore ose leksikore, pra në mënyrë esenciale fjalori dhe gramatika e mësuar për tre vite në shkollën e mesme.

Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për çdo tri fushat e sipërpërmendura:

Të lexuarit dhe të Kuptuarit (Okuma - anlama)
<ul style="list-style-type: none">- Pyetje mbi përmbajtjen e tekstit.- Ushtrime me përzgjedhje fjalësh ose frazash.- Plotësimi i vendit bosh me informacionin e duhur (Bo lukları doldurma).- Ushtrime me përgjigje po/jo.- Ushtrime me e vërtetë/e rreme (Do ru yanlı).- Ushtrime me disa alternativa (ıklı, do ru ıkın seçilmesi).- Ushtrime ku i kërkohet marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.- Ushtrime ku i kërkohet reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.- Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve (Paragrafların düzenlenmesi).- Ushtrime ku i kërkohet paraqitja e elementëve provues që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi.- Ushtrime ku i kërkohet thellim në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
Yazma (të Shkruarit)
<ul style="list-style-type: none">- Shkrimi i një <i>email</i>-i, ku i tregohet një miku rreth një eksperience që ka lënë mbresa.- Shkrimi i një letre formale ose jo formale.

- Aplikime ose rekomandime për një punë *part-time*.
- Shprehja e mendimit rreth një çështjeje të caktuar.

Türkçenin kullanımı (Gramer- Sözlükçe) Përdorimi i Gjuhës

- Ushtrime me zëvendësim, zëvendësimi i një fjale me një të ngjashmen e saj.
- Ushtrime transformimi, shprehja e një fjalie me një strukturë tjetër, por duke ruajtur kuptimin e fjalisë.
- Ushtrime me shumë zgjedhje/ alternativa (ikli).
- Ushtrime me plotësime vendesh bosh, vendosja e fjalës së duhur.
- Ushtrime me ndërtim fjalish.
- Ushtrime me gjetje dhe korrigjime gabimesh.
- Esle tirmeler.

Struktura e Provimit në përqindje

Aspektet Gjuhësore që do të vlerësohen	Përqindja
Okuma - anlama Të Kuptuarit e një teksti të shkruar (letrar ose joletrar)	40%
Türkçenin kullanımı (Gramer ve sözlükçe) Përdorimi i Gjuhës (gramatika dhe leksiku)	40%
Yazma Të Shkruarit (ese' ose krijim, një letër, kërkesë, përshkrim, artikull, përmbledhje, etj.)	20%

3. Përmbajtja e Programit

Fushat tematike dhe leksiku

Përmbajtja tematike është mbështetur në programin e zhvilluar gjatë tre viteve të Kolegjit Turk si edhe në tekstet shkollore për gjuhën turke. Tematika e mëposhtme, e parashikuar për provimin e maturës, do të përfshijë temat bazë sipas programeve, si dhe nëntemat e marra nga tekstet e gjuhës turke.

Tematika (Konular)

- **Günlük hayat** (yemekler, yerel yemek kültürü; sporlar; ki isel tercihler, bo zaman, hobiler, ilgiler)
- **Etrafımızdaki dünya** (seyahat, dünyadaki güzel yerler; para ve alı veri ; tabiat.)
- **Ö renme dünyası ve i** (Okul problemleri, i görü meleri, e itim, okuldaki arkadaşlıklar, vb.)

- **Ki isel ve toplumsal hayat** (Sa lık problemleri, kaza ve hastalıklar; giyim; özel günler ve kutlamalar; insanların fiziki özellikleri, vb.)
- **leti im dünyası** (TV programları, , filmler, radyo programları, mektup e posta vb.)

Leksiku

Në bazë të temës, përzgjidhet gjuha dhe aktet gjuhësore si edhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e komunikimit rreth një teme të caktuar. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për t'u shprehur thjeshtë dhe saktë me shkrim.

Aktet dhe funksionet komunikative

Sugjerohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, të cilët shërbejnë si mënyrë orientuese për hartimin e testit dhe vlerësimin e nxënësve. Aktet dhe funksionet komunikative japin shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë tre viteve të Kolegjit Turk.

- Igi ve tercihler
- zinler emirler yasaklar
- Ki isel bilgiler ve nasihatlar
- Dü ünceleri ifade etme
- Tavsiyeler bir konuyu tartı ma
- Yerler hakkında tavsiyeler
- Olasılık ihtimal vb.

Elementët dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, si me gojë ashtu edhe me shkrim, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqëndruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuara gjatë tre viteve të Kolegjit Turk.

Fiil cümlesi:

- imdiki zaman, geçmi zaman, gelecek zaman vb,
- **Ek fiil ve: Ek fiilin geni zamanı ek fiilin geçmiş zamanı**
- **Aktarma cümleleri** (olumlu olumsuz soru)
- **Etken edilgen:** (geçi li, geçi siz)
- **art kipi:** (Dilek art kipi cümle ve örneklerle peki tirilmesi)
- **Yeterlik fıllı** (olumlu, olumsuz, soru)
- **Sıfatlar** (sıfatlarda derecelendirme)
- **Ekler ve deyimler**
- **Zarflar**
- **Ba laçlar** (ve, ile, ama, fakat, ki vb.)

Önemli bir duyuru!

Kullanmak istedi iniz dilde dü ünebilmeniz. fadeleri, veya bir metni akılda tutmak bu dili konu mak için yeterli sayılmaz. Ö rendi iniz dili günlük hayatta rahatlıkla kullanabilmelisiniz. Dil yaratıcılık gerektiren bir olgudur. Kursu düzenli ve hassasiyetle takip etti seniz ‘Matura Sınavı’bir sürpriz olarak kar ınıza çıkmaz.